

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit prill, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 6 mbledhje, që kanë rezultuar në 27 vendimmarrje, ndër të cilat:

1. Licencimin e shoqërive "RENEW" shpk dhe "SOLAR HORIZON" sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga një central fotovoltaike, me kapacitet prodhues prej 2 MW secila, të vendosura në Qarkun Fier. Këto licenca janë dhënë për një afat 30-vjeçar; si dhe rinovimi i licencës së shoqërisë "GEGA-G" shpk për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin nr. 64, datë 08.04.2020, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 09.04.2025.
2. Përfundimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj.
3. Dhënien e autorizimit për shoqëritë:
 - "AlbEsp Trading & Consulting" shpk për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë.
 - "YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA" sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
 - M.C. ENERGJI GOJAN" sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, si dhe për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të shoqërisë "M.C. ENERGJI GOJAN" sh.p.k, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Banka OTP Albania" sha (për kontratën datë 28.03.2025).

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Raporti Vjetor

Tarifa dhe çmime

Seanca dëgjimore

Platforma PCT

Aktivitete

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Procedura të filluara gjatë muajit Prill:

- Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive “SPV Blue 2” shpk dhe “NAD Investment” shpk në veprimtarinë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike;
- Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GreenNat Solar Park Ballsh” shpk; për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj.
- Fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2024.

Në mbledhjen e tij të datës 8 prill Bordi vendosi mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), për muajin shkurt 2025 prej 13.41 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

Rishikim i vendimeve të ERE

Ndryshime në vendimarrje të marra më parë si rezultat i plotësimit të kushteve të vendosura nga ERE:

- 1.Shfuqizimin e pikave 2 dhe 3 në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 254, datë 23.08.2023 “Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”, i ndryshuar.
- 2.Shfuqizimin e pikave 2 dhe 3 në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 233, datë 19.07.2023 “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- 3.Shfuqizimin e pikës 2 në vendimin e Bordit të ERE-s nr 241, datë 02.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongestionëve.

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit të energjisë elektrike dhe menaxhimin e kongestionit në rrjetin e transmetimit dhe ka për qëllim qasjen e barabartë dhe transparente në kapacitetet ndërkufitare për të gjithë pjesëmarrësit në treg; shfrytëzimin efikas të rrjetit të transmetimit dhe minimizimin e kufizimeve teknike që mund të pengojnë fluksin e energjisë si dhe harmonizimin me legjislacionin evropian, duke transpozuar Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 dhe vendimet përkatëse të Komunitetit të Energjisë.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike, të cilat shkurtimisht janë:

- Përfshirja dhe e sektorit të gazit natyror, përveç atij të energjisë elektrike.
- Titulli ndryshon në “Rregullorja për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë”, për të reflektuar përfshirjen e operatoreve që operojnë në sektorin e gazit natyror.
- Identifikohen entitete të reja si OSHEE, Termocentrali i Vlorës, dhe HEC Vlushë si infrastrukturë e rëndësishme e informacionit në sektorin e energjisë elektrike.
- Përditësime në përkufizimin e “Operatorit të infrastrukturës kritike” dhe ndryshime për të përfshirë infrastrukturën e rëndësishme.
- Të gjithë operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme duhet të pajisen me certifikim ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve.
- Plotësim me referenca me ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” si dhe me referencat ndaj ligjit për gazin natyror.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

Seanca dëgjimore

Gjatë muajit prill, ERE ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore me konsumatorë dhe subjekte të licencuara, duke adresuar çështje të ndryshme që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë nga ERE. Këto takime u fokusuan në:

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes një konsumatori fundor dhe të licencuarve FSHU sha dhe OSSH sha mbi moskreditim e disa faturave.
2. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes një shoqërie dhe FSHU sha përmbi detyrimet e likujduara nga shoqëria palë ankimuese, për llogari të Autoritetit Rrugor Shqipëtar.
3. Diskutimin me përfaqësues të OST sha mbi detyrat e lëna nga ERE me anë të vendeimit nr.279/2024, mbi rishikimin e komponentes nxitëse për ruajtjen e neutralitetit financiar lidhur me shërbimet e tregut balancues.
4. Shqyrtimin e kërkesës së tre shoqërive të licencuara në prodhimin e energjisë elektrike nga parqe fotovoltaike, mbi lëshimin e garancive të origjinës për periudhën 1 mujore, duke nisur nga data 20.12.2023, e cila është data e fillimit të prodhimit.

Këto seanca janë një tjetër mekanizëm i ERE në objektivin e saj për transparencë dhe rritje të efikasitetit të shërbimeve nga ERE, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Publikime

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me regjistrat e [licencimit të subjekteve](#), [të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të përditësuar, si dhe [tarifat dhe çmimet](#) të miratuara nga ERE. Po ashtu në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, neni 19, gërma k), gjenden të publikuara në faqen e internetit të dhëna për vitin 2024 për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në linkun e mëposhtëm: (https://ere.gov.al/media/files/2025/02/17/media/files/2025/01/08/PUBLIKIMI_12-Mujor_2024.pdf)

Aktivitete

U organizua më 8 prill në Tiranë, Seminari i 11-të i Balkan Energy School "Bazat rregullatore në tregjet e gazit natyror", nën kujdesin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE) anëtare themeluese e BES, duke mbledhur bashkë ekspertë dhe institucione për të diskutuar integrimin e tregjeve të gazi natyror dhe dekarbonizimin, në kuadër të Programit të Shkëmbimit të Njohurive (KEP) e mbështetur nga CEI. Iniciativa Qendrore Evropiane (CEI) po punon tashmë me Shqipërinë, Bosnje & Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi për të përafruar kuadrin rregullator me standardet e Bashkimit Evropian. Kjo nismë forcon nder te tjera kapacitetet institucionale dhe kontribuon në ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe të ndërlidhur energjetike për Rajonin.

Në këtë seminar u mbajtën referime dhe prezantime nga përfaqësues të dalluar të Agjencisë Ndërkombëtare e Energjisë (IEA), ACER, Energy Traders Europe, Shell dhe ICIS - Independent Commodity Intelligence duke ofruar njohuri të vlefshme mbi tregtinë me shumicë të gazit, zhvillimet e LNG-së dhe kornizat rregullatore të BE-së. Sesioni theksoi rëndësinë e mekanizmave të bazuar në treg dhe infrastrukturës fleksibël në arritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Raporti vjetor 2024

Enti Rregullator i Energjisë ka dorëzuar në përfundim të muajit mars, Raportin Vjetor për vitin 2024 në Kuvendin e Shqipërisë. Ky raport i përvitshëm paraqet në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për vitin 2024, si dhe krahasimet e disa prej treguesve kryesorë të këtij viti me vitet paraardhës. Në raport gjithashtu do të gjeni informacion mbi aktivitetin e ERE-s në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj, gjatë vitit që lamë pas, si dhe objektivat kryesorë për vitin 2025.

Për ta shfletuar më tej ju ftojmë të vizitoni linkun e mëposhtëm:

https://ere.gov.al/media/files/2025/04/03/media/files/2025/03/05/Raporti_Vjetor_2024.pdf

Njoftim për Klientët në treg të lirë

Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV/ 20 kV/ 10 kV që kanë plotësuar kriteret teknike për daljen në treg të lirë, tashmë kanë të drejtë të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre. Aktualisht janë të licencuar në ERE në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike, 38 furnizues të energjisë elektrike.

ERE ka implementuar Platformën e Krahasimit të Çmimeve (PCT) në tregun e lirë, e cila është bërë e aksesueshme për të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike dhe konsumatorët, në faqen zyrtare të ERE-s: <https://pct.ere.gov.al/>.

Platforma e Krahasimit të Çmimeve (PCT) përmban disa elementë që ndihmojnë në rritjen e transparencës së tregut dhe përmirësimin e përvojës së konsumatorit në tregun e lirë të energjisë. Këta elemente ndihmojnë konsumatorin në vendimmarrje dhe sigurimin e informacionit të qartë dhe të saktë mbi opsionet e furnizimit me energji.

Deri në fund të muajit prill 2025, Furnizuesit kanë publikuar nëpërmjet Platformës PCT një gamë ofertash me çmime dhe nivele tensioni të ndryshme, që ofron mundësi zgjedhjeje për konsumatorët në tregun e lirë. Çmimi për kWh ndryshon varësisht nga niveli i tensionit dhe fasha e konsumit, duke reflektuar kushte të ndryshme të furnizimit si dhe duke iu referuar periudhës së ofertës të paraqitur prej tyre. Konsumatorët kanë mundësi të zgjedhin midis një numri të konsiderueshëm mundësish që u përshtaten nevojave të tyre energjitike, si për nivelin e tensionit ashtu edhe për çmimin. Këto oferta janë një përpjekje për të ofruar mundësi konkurruese në një treg që po zhvillohet, ku çmimi dhe kushtet e ofrimit mund të ndihmojnë në përshtatjen e konsumatorëve me ndryshimet e mundshme të çmimeve dhe nevojave energjitike.

